

Kjo MARRËVESHJE është lidhur më 21.02.2025.

NDËRMJET:

Z. Përparim Kalo, lindur në Kuçovë, Shqipëri, më 12.12.1957, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal F71212078J (më poshtë referuar si "**Shitësi**"),

dhe

Znj. Shirli Mani, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 26.02.1985, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal I55226060R, (më poshtë referuar si "**Blerësi**").

HYRJE:

- (A) Shitësi është ortak tek shoqëria "KALO&ASSOCIATES" SHPK shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, subjekt i së drejtës Shqiptare, e regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 33260, datë 29 mars 2005 dhe me NUIS K31910009D ("**Shoqëria**").
- (B) Shitësi, duke qenë zotërues dhe përfitues ligjor i 69% të totalit të kapitalit shoqëror të Shoqërisë dëshiron të shesë 7.5% (shtatë pikë pesë për qind) të pjesëmarrjes së tij në kapitalin e Shoqërisë ("**Kuota e Shitjes**"), dhe Blerësi dëshiron të blejë dhe zotërojë Kuotën e Shitjes nga Shitësi, të lirë nga çfarëdolloj barre dhe bashkë me të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat e ndryshëm, në kushtet dhe afatet e parashikuara në Marrëveshjen për Shitjen e Kuotës nënshkruar në datën 21.02.2025 ("**Marrëveshja për Shitblerjen e Kuotës**").
- (C) Shitësi ka kryer të gjitha formalitetet e nevojshme sipas statutit të Shoqërisë, pasi ortakët ekzistues kanë hequr dorë nga e drejta e parablerjes, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë që autorizon Transaksionin më datë 21.02.2025.
- (D) Për qëllime të regjistrimit në Shqipëri, palët kanë vendosur të nënshkruajnë këtë Instrument Transferimi.

PALËT BIEN DAKORD si vijon:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIMIE

- 1.1 Termat me shkronjë të mëdha të përdorura dhe që nuk janë përshkruar ndryshe në këtë Marrëveshje do të kenë kuptimin që u është dhënë në Marrëveshjen e Shitblerjes së Kuotës 1. Më tej, termat në vijim do të kenë kuptimin si më poshtë vijon:

"**Marrëveshje**" është ky Instrument Transferimi.

"**Barra**" është çdo interes ose kapital i çdo personi (përfshirë çdo të drejtë për të blerë, opSION ose të drejtë parablerjeje) ose çdo hipotekë, detyrim, peng, barrë, dhënie të

drejte, hipotekë, interes sigurie, mbajtje titulli ose marrëveshje tjetër sigurie ose marrëveshje.

“Kuota e Shitur” është pjesa e 1 (një) kuote të Shitësit në Shoqëri, e emetuar dhe paguar plotësisht dhe e cila përbën 7.5% të kapitalit të Shoqërisë.

- 1.2 Në rast mospërputhje ndërmjet kushteve të kësaj Marrëveshje dhe kushteve të Marrëveshjes së Shitblerjes së Kuotës, ose për çdo çështje tjetër jo të parashikuar në Marrëveshjen e Shitblerjes së Kuotës, kushtet e Marrëveshjes së Shitblerjes së Kuotës do të kenë përparësi dhe mbeten efektive sa më shumë të jetë e mundur,
- 1.3 Për shmangien e dyshimeve, kjo Marrëveshje është dokumenti që përbën transferimin e Kuotës së Shitur nga Shitësi tek Blerësi dhe dokumenti i vetëm që kërkohet të regjistrohet pranë çdo autoriteti ku kërkohet regjistrimi i këtij transaksioni.

2. SHITJA DHE BLERJA

Sipas afateve, çmimit dhe kushteve të Marrëveshjes së Shitblerjes së Kuotës, Shitësi shet dhe Blerësi blen, me garanci të plotë të titullit dhe të lirë nga çdo barrë, Kuotën e Shitur dhe çdo të drejtë të lidhur me Kuotën e Shitur.

3. CMIMI I BLERJES

- 3.1 Çmimi i Blerjes do të paguhet nga Blerësi Shitësit në përputhje me parashikimet e Marrëveshjes së Shitblerjes së Kuotës.

4. TRANSFERIMI I TITULLIT TË KUOTËS

- 4.1 Titulli i Kuotës së Shitur i transferohet Blerësit menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.
- 4.2 Pas transferimit të Kuotës së Shitur, Blerësi do të bëhet zotëruesi i 7.5% të kapitalit të Shoqërisë.

5. GARANCI TË TJERA

Shitësi do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar që çdo palë e tretë e nevojshme të nënshkruajë dhe dorëzojë menjëherë dokumentet dhe kryejë veprimet që Blerësi mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për t'i dhënë Blerësit titullin e plotë, të pabarrësuar, ligjor dhe pronësinë përfituese në dhe për Kuotën e Shitur.

6. NDRYSHIMET

Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshjeje nuk do të jetë i vlefshëm përveçse nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët (ose përfaqësuesit e autorizuar nga to).

7. LIGJI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI

- 7.1 Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjin e Shqipërisë, dhe çdo mosmarrëveshje do të zgjidhet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8. EKZEMPLARË

Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet në çfarëdolloj numri ekzemplarësh, secili prej të cilëve është origjinal kur nënshkruhet dhe dorëzohet dhe të gjithë së bashku evidentojnë të njëjtën marrëveshje.

Kjo Marrëveshje është lidhur në datën e shënuar në fillim të saj.

[Faqja e nënshkrimeve vijon]

NËNSHKRUAR nga PËRPARIM KALO


[nënshkrim]


Përparim Kalo

Nënshkrim

Emri

NËNSHKRUAR nga SHIRLI MANI

[nënshkrim]


Shirli Mani

Nënshkrim

Emri